



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2021

**V E N D I M**

**Nr. 23, Datë 05/02/2021**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 127, datë 30.10.2020, e znj. D. P., ku pretendohet diskriminimi i vajzës së saj, E. Z.<sup>1</sup>, nga ana e Drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “28 Nëntori”, Laprakë, Tiranë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Mbështetur në ankesën e znj. D. P., e cila është nëna dhe përfaqësuesja ligjore e vajzës së saj, E. Z. është nxënëse pranë Shkollës 9-vjeçare “28 Nëntori”, Laprakë, Tiranë. Familja e vajzës i përket besimit fetar mysliman dhe vajza ka vendosur mbulesë, të cilën e mban edhe në shkollë.

Për sa më sipër, ankuesja pretendon se në datën 19.10.2020, ajo është takuar me Drejtorin e Shkollës 9-vjeçare “28 Nëntori”, Laprakë, i cili i ka shpjeguar se vajza e saj, duhet te largohet nga shkolla për shkak të mbulesës që vendos, pasi kjo veshje është në kundërshtim me rregulloren e institucionit arsimor. Znj. D. P. thekson faktin se i ka kërkuar titullarit të shkollës t’ia bëjë të ditur zyrtarisht një fakt të tillë, por ai nuk ka pranuar.

<sup>1</sup> Në kushtet kur, nxënësjë E. Z. është nën moshën 18 vjeç, ajo përfaqësohet ligjërisht pranë KMD-së nga prindi i saj;

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Në këtë kontekst, znj. D. P. shprehet se vajza e saj po diskriminohet, pasi është përjashtuar nga e drejta për t'u arsimuar, si pasojë e bindjes së saj fetare.

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në datën 18.11.2020, kanë hyrë në fuqi ndryshimet ligjore, të miratuara me ligjin nr. 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi””<sup>3</sup>. Meqënëse çështja objekt i këtij shqyrtimi administrativ është paraqitur përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 124/2020, atëherë Komisioneri vlerëson se çështja duhet të shqyrtohet sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të pandryshuar.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “c”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”<sup>4</sup>, që i jep të drejtën për të hetuar dhe shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Ligji nr.10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, **bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.**”

Neni 3, i Ligjit nr.10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Ndërsa në Kreun III, të ligjit parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën arsimit. Ky ligj në nenin 17, pikat 1 e 2, të tij parashikon se: “1. Ndalohet çdo dallim, kufizim ose përjashtim që

<sup>3</sup> Ligji nr.124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, është botuar në Fletoren Zyrtare Nr.191, datë 03.11.2020.

<sup>4</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

*bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) krijimin e institucioneve publike ose private që ofrojnë shërbime arsimore ose profesionale; b) financimin e institucioneve publike që ofrojnë shërbime arsimore ose profesionale; c) përmbajtjen e parimeve dhe kritereve të veprimtarisë arsimore, duke përfshirë programet mësimore dhe metodat e mësimdhënies; ç) trajtimin e studentëve ose nxënësve, duke përfshirë pranimin, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore ose përjashtimin e tyre. 2.Ndalohet t'i refuzohet një personi ose një grupi personash pranimi në një institucion arsimor publik, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji.”*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 127, datë 30.10.2020, së znj. D. P., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>5</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” (i ndryshuar), Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr.1440/2, datë 03.11.2020, Drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “28 Nëntori”, Laprakë, Tiranë dhe për dijeni Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Zyrës Arsimore Tiranë, si dhe ankueses D. P., ku kërkohej informacion mbi pretendimet e parashtruara nga ankuesja.
  - 1.** Në përgjigje të shkresës nr.1440/2, datë 03.11.2020, së Komisionerit, Drejtori i Shkollës 9-vjeçare “28 Nëntori”, Laprakë, Tiranë, dërgoi shkresën nr. 1754 Prot., datë 19.11.2020, nëpërmjet, së cilës informon se nxënësja E. Z. është pranuar pa asnjë lloj pengese në Shkollën 9-vjeçare “28 Nëntori”, Laprakë, që në ditën e parë, kur prindi i saj ka paraqitur

---

<sup>5</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon:“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

kërkesën për regjistrim. Nxënëses në fjalë i është plotësuar fleta e pranimit nr. 1600 prot., datë 04.09.2020, e cila mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi është miratuar edhe nga specialisti përgjegjës pranë Zyrës Vendore Arsimore Tiranë.

Në shkresë theksohet fakti se prindit të nxënëses i është bërë e ditur rëndësia e respektimit të Rregullores së Shkollës dhe pjesëmarrjes së nxënëses në të gjithë procesin mësimor-edukativ. Një ndër pikat e kësaj Rregulloreje është edhe paraqitja me uniformën e përcaktuar nga Rregullorja e shkollës. Drejtori i Shkollës sqaron se në asnjë moment nxënësja nuk është larguar shkolla nga ana e tij, sikurse pretendohet nga prindi i fëmijës. E. Z. vazhdon të jetë nxënëse e klasës së 7-C. Një fakt i tillë vërtetohet nga prezenca e saj në shkollë dhe nga detyrat e kryera dhe të dorëzuara nga ana e saj.

C. Në vijim të procedurave hetimore, Komisioneri vendosi zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 05.02.2021, ku palët do të kishin mundësi ballafaqimi ndërmjet tyre.

- Nëpërmjet një e-maili të dërguar në adresë të KMD-së në datën 03.02.2021, ankuesja D. P. kërkon të tërhiqet nga ankesa e saj, duke theksuar faktin se nga momenti që ajo ka depozituar këtë ankesë pranë Komisionerit, vajza e saj vijon normalisht mësimin pranë Shkollës 9-vjeçare “28 Nëntori”, Laprakë.
- Në vijim, Komisioneri anuloi seancën dëgjimore të datës 05.02.2021, duke kryer njoftimin e palëve.

Në këto kushte, u konsiderua se qëllimi, për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrotjtjen nga Diskriminimi” (i ndryshuar), ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”*, KMD vlerësoi se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa. Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”<sup>6</sup>, Komisioneri deklaroi përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

---

<sup>6</sup> Neni 94/1, i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikon: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.”*

## **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 12-13 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” (i ndryshuar),

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I:**

1. Përfundimin e procedurës së shqyrtimit administrativ të ankesës 127, datë 30.10.2020, i znj. D. P., për shkak se ankuesja është tërhequr nga ankesa, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha – Arsim

Shkak – bindja fetare

Lloji i Vendimit - Përfundimin e procedurës së shqyrtimit/tërheqje e ankuesit